

## Krijimi i llogaris së re në platformën Moodle-Gjilan

1. Fillimisht bëhet hyrja në e-Learning( Linku përkatës në Web faqen e UKZ ose direkt hyrje në server përmes IP: **80.80.173.124**).




Fig.1

2. Pas klikimit të linkut e-Learning ( ose vendosje IP 80.80.173.124 në Browser) si që shihet në Fig.1 do të shfaqet dritarja e Moodle dhe aty mundemi të ndërrojmë gjuhën e komunikimit me sistemin. Për të komunikuar në gjuhën shqipe me sistemin Moodle duhet të zgjidhet opsioni Shqip(Sq) si që shihet në Fig.2 në vijim.




Fig.2

3. Krijimi i llogarisë së re në sistem bëhet vetëm një herë. Në fig.2 në anën e djathtë klikohet linku: **Fillo tani duke krijuar një llogari të re!** si shihet në Fig.3.




Fig.3

4. Pasi të klikohet linku **Fillo tani duke krijuar një llogari të re!** Do të shfaqet dritare dialoguese e cila shihet në Fig.4 ku do të futen të dhënat:
  - a. **Emri i përdoruesit**( Këtë duhet shkruar me shkronja të vogla p.sh. **basri123**. Këtë e shënoni në ndonjë fletë sepse do të të duhet për hyrje në Moodle. Nëse e harroni duhet administratori ta restartojë të njëjtin).
  - b. **Fjalëkalimi**( duhet të përmbajë 8 karaktere Shkronjë të madhe, shkronjë të vogël, numër dhe ndonjë shenjë p.sh. **Abcdef1#**. Edhe këtë e shënoni dikund.
  - c. **Vendosje të e-mailit tuaj** ( nuk ka rëndësi ku e keni krijuar) dhe ri shkrimin e saj më poshtë
  - d. Vendosje **Emri, Mbiemri, Qyteti**
  - e. Vendosje **Shteti** ( Në këtë version Moodle 3.2 kemi bë të mundur që në listën e shteteve të figurojë emri i shtetit tonë Kosovë. Këtu duhen falënderuar studentët Qëndresa Shahini, Arbian Shkodra, Rinor Selimi, Ilmi Hajdini dhe Shkodran Berisha që pas një përpjekje lokalizuan fajllin dhe ndryshuan kodin në të cilin vendosëm emrin e shtetit më të ri në Evropë Kosovë. Veprim ndoshta i vogël por ne të gjithë u gëzuam dhe festuam.
  - f. Në fund shtypet opsioni Krijo llogarinë time të re ( Nëse keni bë gabime gjatë mbushjes së kësaj dritareje dialoguese sistemi do t'ju kthejë pas deri sa të përmirësohet gabimi. Gabime më të shpeshta mund të jenë: emri i përdoruesit duhet shkruar me shkronja të vogla, nëse ky emër është rezervuar më parë sistemi nuk lejon tjetër atëherë i shtoni ndonjë shifër pas, fjalëkalimi duhet të ketë minimum 8 karaktere ku pa tjetër të ketë së paku një Shkronjë të madhe, të vogël, numër dhe shenjë.)




Fig.4

5. Pasi keni mbushur të dhënat në fig. 4 shtypet **Krijoni llogarinë time të re** ( nëse keni bërë gabime në fute të të dhënave sistemi do t'ju kthejë pas ndoshta disa herë deri sa të dhënat të saktësohen dhe kompletohen). Nëse është gjithçka në rregull pas klikimit të linkut **Krijoni llogarinë time të re** do të shfaqet mesazhi i cili tregon se është hapur llogaria juaj si që shihet në fig.5. Këtu tregohet se përfundimi i regjistrimit do të bëhet pasi ju të hyjni në e-mailin tuaj që tash e keni përdorur ku serveri ka dërguar kod për konfirmim.




Fig.5

6. Hapim e-mailin tonë dhe aty gjejmë udhëzime se si bëhet konfirmimi. Nëse në linkun që shihet në fig.6 nuk lejohet që të klikohet direkt atëherë kopjohet ajo pjesë dhe vendoset lartë në Browser dhe klikohet enter. E-maili i hapur shihet në Fig.6.




Fig.6

7. Pasi shtypet ky link do të shfaqet mesazhi për të lajmëruar se procesi i regjistrimit dhe **konfirmimit** ka përfunduar dhe lartë në faqen e sistemit Moodle do të shihet se ju jeni i loguar. Kjo shihet në fig.7 në vijim.




Fig.7

### KJO MËNYRË E HAPJES SË LLOGARISË SË RE ËSHTË E NJËJTË PËR TË GJITHË PËRDORUESIT(studentë, mësues, administrator)

**PROFESORI-** pasi bën hapjen e llogarisë së re në Moodle i drejtohet me e-mail administratorit të sistemit që për momentin është([basri.ahmedi@uni-gjilan.net](mailto:basri.ahmedi@uni-gjilan.net)) nga i cili kërkon:  
 -kërkesë për çelësat për lëndët që i ligjëron( Fakulteti, viti, lënda)  
 -kërkesë që për këto lëndë profesorit në fjalë t'i jepet statusi Teacher

**STUDENTI-**Deri tash është bërë procesi i regjistrimit dhe konfirmimit në sistemin Moodle por me këtë nuk mund të hysh në lëndët pa pasur çelësin e lëndës të cilin e merr nga profesori i lëndës. Me këtë studenti duhet të shkojë te faqja kryesore, fillimisht bëhet hyrja e në e-Learning( Linku përkatës në Web faqen e UKZ), vendos User dhe pasword që vetëm ai i din. Pas llogimit zgjidhet fakulteti, viti dhe kursi ku duhet të bëheni anëtar p.sh. **UNIVERSITETI KADRI ZEKA/Fakulteti i Shkencave Kompjuterike/Viti parë/Qarqe logjike. Fig.8**




Fig.8

Pasi klikohet emri i lëndës( vetëm herën e parë) hapet dritarja dialoguese ku vendoset çelësi(Self enrolment i cili merret nga profesori i asaj lënde) dhe ju jeni anëtar i grupit të studentëve që e ndjekin këtë lëndë e kështu i keni të gjithë të drejtat e studentit. Kjo shihet në fig. 9.




Fig.9

Pasi futet çelësi klikohet Enrol me **Enrol me** dhe do të hyni në lëndën p.sh. në këtë rast Qarqe logjike ku mund t'i shfrytëzoni të gjitha të drejtat që i takojnë studentit në lëndën Qarqe logjike. Fig.10




Fig.10

Përgatiti: Prof. Ass.Dr.Basri Ahmedi  
02.02.2018  
Gjilan